



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes”


i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti Aleksandër Moisiu” Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD. Elena KOKTHI 

PhD. Jonida TETA 

Mars / 2020


PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës (UAMD) është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005. Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.10, date 07.04.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2021.

Aktualisht UAMD përbëhet nga gjashtë Fakultete më konkretisht:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. Fakulteti i Edukimit;
3. Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike;
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale;
5. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP);
6. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Master Profesional (MP) në "Planifikimin e Burimeve të Ndërmarrjes" i ofruar në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Licensimi i këtij programi është bërë me Urdhër Nr. 651, datë 11.10.2018 të MASR. Hapja e MP në "Planifikimin e Burimeve të Ndërmarrjes" ka ardhur si nevojë e tregut për specialistë në fushën e informatikës dhe biznesit dhe programi është hartuar me ndihmën teknike të biznesit. Ndërthurja e nevojave të biznesit në këtë program, me lëndë ekzistuese të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si dhe lëndë të karakterit praktik, rrit mundësinë e punësimit të menjëhershëm të studentëve. Gjithashtu ofrimi i lëndëve nga pedagogë të huaj për kohortin e parë të studentëve i jep mundësinë lektorëve të UAMD-së, të përgatiten për ofrimin e moduleve në të ardhmen. Stafi i angazhuar në këtë program studimi është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Megjithatë GVJ konstaton se duhet të bëhen më shumë përpjekje për të komunikuar në kanale të ndryshme informimi në mënyrë që të zgjerohet baza e studentëve që aplikojnë në këtë program studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Planifikimin e Burimeve të Ndërmarrjes” i ofruar në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit., filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, date 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Planifikimin e Burimeve të Ndërmarrjes”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje PhD Elena Kokthi, dhe PhD Jonida Teta. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL. Vizita 2 ditore në UAMD u realizua gjatë datave 25/11/2019 dhe 18/12/2019, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, me stafin e sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me pedagogët, studentët etj. Gjatë këtyre takimeve u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse. Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.02.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4/20 Prot, datë 17.02.2020. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës përcjell pranë ASCAL më datë 25.02.2020, nëpërmjet shkresës me Nr.337/2 Prot, datë 24.02.2020, përgjigje në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare duke përgatitur profesionistë në fushën e sistemeve të planifikimit që do të punojnë për këtë drejtim. Programi i studimit synon nxitjen dhe respektimin e vlerave kombëtare, në përputhje të plotë edhe me misionin e UAMD, sipas të cilit, zgjerimi i njohurive dhe aftësive esenciale për transformim personal, nëpërmjet nxitjes së një mjedisi dinamik është parësor, ku transparenca dhe kreativiteti fertilizojnë përgatitjen e studentëve . <i>Aneks 1. Statuti UAMD</i> <i>Aneks 2. Strategjia e zhvillimit të UAMD</i>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi në fjalë, mbështetet në misionin kryesor të UAMD, për të përcjellë një edukim cilësor, me anë të gërshetimit të një kërkimi shkencor të vlefshëm, që të jetë në funksion të nevojave dhe të dijes së shoqërisë shqiptare. Kjo konfirmohet dhe nga statuti i UAMD, ku misioni kryesor është t’u japë studentëve një edukim cilësor t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, duke përgatitur profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike. <i>Aneks 1. Statuti UAMD</i>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit MP për sistemet ERP është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimin e UAMD-së që është: zhvillimi i arsimit shkencës dhe ekonomisë, të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar, të realizojë kualifikime shkencore të personelit akademik në fushat e shkencave të mirfillta teorike dhe të shkencave të zbatuara, si dhe të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme, si për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit. Ky program është në përputhje të plotë dhe me fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Teknologjisë së

	<p>Informacionit, ku qëllimi është të formojë specialistë dhe profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit sipas një programi universitar të integruar me praktikën profesionale.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti UAMD</i></p> <p><i>Aneks 4. Rregullore FTI</i></p>								
<p>Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MP në ERP është ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me biznesin dhe ka për qëllim të formojë profesionistë në fushën e sistemeve të informacionit. Një tjetër synim i këtij program studimi është që të formojë profesionistë të aftë për të ofruar shërbime në distancë (outsourcing) për klientë ndërkombëtarë. Bashkëpunimi i suksesshëm ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar duke ofruar në Shqipëri një shërbim të ri për klientë të njohur kombëtar dhe ndërkombëtarë.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi I.2</p> <p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, konstatohet nga ana e GVJ se programi i studimit MP në sistemet ERP, është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit. Ai është konform objektivave strategjike për zhvillimin, gjithashtu, organizimi i këtij programi është bërë në përputhje me Statutin e Institucionit.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti UAMD</i></p> <p><i>Aneks 2. Strategjia e zhvillimit të UAMD</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të UAMD-së, (Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) si dhe nga vizita në institucion, GVJ arrin në përfundim se: organizimi i programit të studimit MP në sistemet ERP, është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Aneks 2. Strategjia e zhvillimit të UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi,</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Sistemet e</p>

<p>organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), pjesë e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI) në UAMD. Ky program i fokusuar në fushën e sistemeve të informacionit, është në përputhje të plotë me drejtimin akademik dhe fushat prioritare të FTI dhe të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit (DTI) që është përgjegjës për këtë program studimi</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në sistemet ERP është hartuar në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. GVJ gjykon që programi i studimit përputhet me nevojat aktuale lokale dhe globale në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe reflekton jo vetëm nevojat e biznesit në formën e outsourcing të burimeve njerëzore shqiptare por edhe nevojat në rritje për kompetencat që ofrohen nga ERP nga biznesi vendas.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="577 1075 762 1173">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="769 1075 970 1173">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="976 1075 1177 1173">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1184 1075 1380 1173">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të</p>	<p>Programi i studimit MP në ERP ka të përcaktuar qartë objektivat e formimit të studentëve, kompetencat dhe njohuritë që studenti duhet të ketë në hyrje të programit dhe në dalje të tij. Masteri është projektuar për studentët që kanë përfunduar një program studimi universitar prej së paku tre vitesh (bachelor), në fushën e sistemeve të informacionit, informatikës, ekonomisë, teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë. Ky program studimi synon të ofrojë elementet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aftësive në fushën e "Analizës dhe Interpretimit", veçanërisht në dimensionin e "Ekspertizës dhe Teknologjisë së Aplikuar" dhe në veçanti:</p> <p><i>Për aftësitë e Sistemit të Informacionit:</i></p>

<p>punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Modelim dhe Programim • Big Data / Analiza dhe Interpretimi i të Dhënave • Cloud Computing / Arkitektura • Statistikë • Siguria e të dhënave <p><i>Për aftësitë në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i Sistemit • Robotikë / Inteligjencë Artificiale • Mirëmbajtja parashikuese <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>UAMD dhe departamenti përgjegjës për programin e studimit, ka analizuar nevojat e tregut të punës në bashkëpunim me biznesin, për të përshtatur programin e studimit. Identifikimi i kompetencave të nevojitura bëhet në mënyrë të vazhdueshme në bashkëpunim me biznesin. Analiza e aktorëve potencialë në tregun e punës nëpërmjet kërkimit primar plotëson në mënyrë të vazhdueshme kuadrin e kompetencave dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës. Sipas RVB dhe takimit me koordinatorin e programit, studimi i tregut kombëtar dhe ndërkombëtar realizohet nga Crystal System, dhe në bazë të kërkesave të tregut përcaktohen edhe kërkesat për profilin e studentëve.</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP</i></p> <p><i>Aneks 10. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së MP Sistemet ERP</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit, GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit MP në Sistemet e ERP, orientohen kah nevojave të konstatuara në tregun e punës. GVJ nga takimi me aktorë përgjegjës konstatoi që program i studimit është hartuar në përputhje me kompetencat e nevojitura nga biznesi. Ofrimi i praktikës mësimore nga konsulentë të huaj të cilët ishin me profil akademik por edhe profil biznesi, është një element që tregon lidhjen e programit të studimit me nevojat e tregut duke lehtësuar punësimin e studentëve.</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP</i></p> <p><i>Aneks 10. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së MP Sistemet ERP</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion GVJ konstaton se ky program studimi ofrohet për herë të parë në Shqipëri. Për</p>

<p>të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>shkak të specifikave që ky program ka, studentët e diplomuar punojnë vetëm me klientë dhe kompani të huaja dhe programi është projektuar që ti përgatisë studentët për tregun ndërkombëtar. <i>GVJ konstatoi gjatë komunikimit me stafin përgjigjës për këtë program studimi që pajisja e studentëve me gjuhën angleze përbën një pikë të dobët sepse studentët që hyjnë në këtë program studimi nga niveli bachelor nuk kanë njohuri të mira të gjuhës angleze.</i> Studentët informohen vazhdimisht për nevojën e pajisjes me gjuhën angleze si një detyrim për tu regjistruar në programin e studimit MP në ERP. Disa module të këtij programi studimi mundësojnë transferimin e krediteve ndërsa pjesa tjetër është vështirësisht e transferueshme sepse lidhjet me module specifike që reflektojnë disa nevoja të biznesit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavejçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sistemet ERP, ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite Evropiane sipas sistemit ECTS. Diploma që jepet në përfundim të programit të studimit Master Profesional, shoqërohet me suplementin e diplomës. Ky program është vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe Kartës së Bolonjës. Programi i studimit, është hartuar mbi bazën e kritereve dhe standardeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë në udhëzimet e MASR si dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë; ➤ Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ➤ Udhëzimin Nr. 31, datë 19.12.2017 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”; <p>Programi ofrohet me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 1 vit ku studentët përftojnë 60 kredite ECTS (30 për semestër) me një ngarkesë totale prej 900 orë pune (45 orë për kredit).</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP</i></p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional”</p>	<p>Referuar Planit Strategjik të institucionit, GVJ informohet se Institucioni në vizionin e tij e vë theksin në formimin e</p>

<p>përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>gjykit të shëndoshë tek studentët, duke krijuar mundësi për përvetësimin e njohurive specifike teknike e profesionale që të përgatisin për të ushtruar një profesion të caktuar. Programi i studimit MP në ERP ka të parashikuar praktikën profesionale në dy module të cilat zhvillohen nën asistencën e trajnuesve të huaj. Këta të fundit aftësojnë dhe lektorët shqiptarë të cilët do të trajnojnë në vazhdimësi studentët në vitet që vijojnë. GVJ konstatoi që, përgatitja e moduleve nuk është bazuar në modele të tjera të universiteteve apo institucioneve që ofrojnë formime profesionale të këtij lloji. Ndërtimi i moduleve ka ndjekur qasjen biznesit. Gjatë vizitës në institucion përfaqësuesi i biznesit, paraqiti kompetencat e nevojitura dhe më pas kompetencat u përkthyen në module. Praktikën profesionale për studentët zhvillohet në ambjentet e fakultetit si dhe në ambjentet e Crystal System. Profili i MP në Sistemet ERP nuk përfshihet në profesionet e rregulluara.</p>			
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Programi i studimit MP në ERP përfshin elementë të mësimdhënies në gjuhën angleze për vet specifikën e tij. Fakti që studentët do të punësohen në kompani të huaja si dhe përdorimi e terminologjisë së fushës në gjuhën angleze e bën të domosdoshëm njohjen e saj nga studentët. Sa i përket ndërkombëtarizimit, GVJ gjykon që në afatin e shkurtër ky nuk është objektiv i këtij programi studimi për shkak të veçorive shumë specifike që mbart.</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit MP në ERP përmbush plotësisht këtë kriter sepse është hapur në funksion të plotësisht të nevojave në një drejtim të caktuar të biznesit. Ky program studimi ndiqet nga studentë të UAMD nga profile të Teknologjisë së informacionit por edhe nga individë të punësuar në biznese të cilat kanë nevojë për njohuritë praktike të ofruara nga ky program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>FTI dhe më konkretisht DTI, ofrojnë programin e studimit MP në ERP, si struktura përgjegjëse për këtë program studimi, plotësojnë kriteret ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik si dhe të titujve/gradave shkencore. Stafi akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. Stafi me kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi është në masën 100%. Sa i përket gradave dhe titujve, plotësohet kushti ligjor për mësimdhënien në nivelin master. Lektorët disponojnë gradën Doktor dhe Profesor i Asociuar.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 15. Personeli akademik në FTI</i>), Fakulteti Teknologjisë së Informacionit për vitin akademik 2018-2019 ka 48 pedagogë efektivë (PAE), nga ku 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 17 kanë gradën Dr., dhe 30 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit referuar dokumentit (<i>Aneks 16. Personeli akademik i angazhuar në MP Sistemet ERP</i>),</p> <p>për vitin akademik 2018-2019, rezultojnë të jenë të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi gjithsej 7 pedagogë gjithsej, të gjithë pedagogë efektiv (PAE), nga të cilët 1 me titullin Prof.Asoc., 5 me gradën Dr, si edhe 1 asistente-lektore me Msc.</p> <p>Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK thekson mbulimin 100% me staf të brendshëm.</p> <p><i>Aneks 12. CV e stafit akademik të MP Sistemet ERP</i> <i>Aneks 13. Tituj-gradat e personelit akademik</i> <i>Aneks 14. CV e stafit ndihmës akademik MP Sistemet ERP.</i> <i>Aneks 15. Personeli akademik në FTI</i> <i>Aneks 16. Personeli akademik i angazhuar në MP Sistemet ERP</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP në ERP, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015. Ky është një program i fushës së teknologjisë së informacionit i cili ofrohet nga departamenti i teknologjisë së informacionit. Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit, konstatohet se ka përputhshmëri.</p>

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>(Aneks 18. Programet e studimit të ofruara në FTI)</p> <p>Ky program studimi mund të zhvillohet në vijim të programeve të tjera të studimit që ofrohen në ciklin e parë të studimeve si: Teknologji Informacioni dhe Sisteme Informacioni. Po kështu nga departamenti i shkencave kompjuterike në FTI, ofrohen programe studimi në Shkenca Kompjuterike dhe Informatikë. Në lidhje me kodifikimin e programit, institucioni ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve të saj ku për MP në Sistemet ERP kodi i përcaktuar është UAMDMPS-70413-SPBN. Ndërkohë në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ky master është i regjistruar me numër identifikimi DR3417190320.</p> <p><i>Aneks 21. Kodifikimi i Programeve UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master MP në ERP, është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentave si: (Aneks 3. Rregullore UAMD, Aneks 4. Rregullore FTI, Aneks 20. Percaktimi i koordinatorit të MP në Sistemet ERP), GVJ konstaton se ka një ndarje të detyrave dhe përgjegjësisë mes strukturave të institucionit, dhe pesha kryesore për programin e studimit mbulohet nga njësisia bazë përgjegjëse, departamenti i teknologjisë së informacionit. Programi i studimit MP në ERP ka në përbërje të tij module të cilat ofrohen nga Departamenti</p>

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>i Matematikës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit si dhe modulet e menaxhimit apo financës nga Fakulteti i Biznesit.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor të programit MP në ERP, institucioni është në bashkëpunim të plotë me biznesin (Crystal System). Ky i fundit ka paraqitur kompetencat që nevojiten dhe njësia bazë për hartimin e programit në UAMD ka ndërtuar modulet në bashkëpunim me trajnerë të huaj të cilët punojnë në universitete por edhe ne biznese.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi i studimit MP në Sistemet ERP është ndërtuar si rezultat i bashkëpunimit të FTI me Crystal System.</p> <p>Ky bashkëpunim përfshin edhe praktikën profesionale e cila zhvillohet pjesërisht në ambjentet e FTI dhe ambjenteve të Crystal System apo edhe kompanive të tjera.</p> <p><i>(Memorandum UAMD - Crystal System)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor të programit MP në ERP, institucioni ofron trajnime, leksione të hapura, orë informuese për mundësi punësimi apo mundësi trajnimesh jashtë UAMD etj. Përsa i përket MP në Sistemet ERP, përveç trajnimeve të ofruara në bashkëpunim me Crystal System, zhvillohen edhe aktivitete me kompani të tjera si Tetra Solution, AMD (Lufthansa Industry Solution).</p> <p><i>(Aneks 31. Trajnime FTI - Crstal System)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>Ky është një program i ri studimi, dhe koha e zbatimit të këtij programi nuk është e mjaftueshme për të hartuar raporte analitike të rezultateve të bashkëpunimit.</p>

përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi, i cili është me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 ECTS. Ky program është ndërtuar në respekt dhe zbatim të ligjit për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera të legjislacionit vendas në fuqi dhe gjithashtu sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Hartimi dhe përditësimi i programit Master Profesional në “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” është realizuar sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë qëllim në RVB por edhe gjatë vizitës u konstatua se njësia bazë mban lidhje të ngushta me sektorët e punësimit (sektori privat, vendas dhe i huaj), që kanë fokus kryesor fushën e sistemeve të planifikimit të ndërmarrjeve për të siguruar përputhshmërinë e programit të studimeve me nevojat e tregut. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të formimit të IT dhe Biznesit. IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund ti shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Zhvillimi i

	formimit te shprehive të veçanta ne kete program studimi u bë i mundur me studime të mirëfillta duke marrë parasysh mendimin e kompanive të cilat kanë një kërkesë për këta lloj studentësh.
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Ky program studimi synon ta pajisë studentin me njohuri të përparuara teorike mbi përdorimin e sistemit software ERP në ndërmarrje, dhe integron të gjithë funksionet e menaxhimit të aktiviteteve të lidhura me planifikimin e burimeve.
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” i ofruar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit jep njohuri të cilat zhvillojnë aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushen e software ERP dhe moduleve te integruara sipas proceseve organizative të burimeve të ndërmarrjeve. Këto njohuri praktike janë të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse që përqëndrohen në fushat specifike të biznesit.
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 (neni75). Ky program studimi ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik dhe me dy semestra. Referuar RVB studimet përmyllen me provim përfundimtar, ngarkesa e të cilit është 12 kredite, dhe është parashikuar 100% studim individual.
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe ngarkesën përkatëse në kredite. Programi është përcaktuar konform përcaktimit në shtojcën 1 të VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Studeni merr: Në kategorinë A (6 kredite); Në kategorinë B (24 kredite); Në kategorinë C (2 kredite); Në kategorinë D (6 kredite);

	Në kategorinë përmbyllëse E (12 kredite);			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. Referuar planit mësimor praktika profesionale ka një një peshë rreth 10 % të të gjithë programit të studimit. Praktika profesionale ka 6 kredite me një angazhim prej 150 orësh për studentin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Gjithashtu, edhe njësia bazë që është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Grupi i vlerësimit të brëndshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të këtij program studimi. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes” është hapur me UMASR Nr. 651 datë 11.10.2018, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik, 60 kredite.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ky fakultet, ka në përbërje 3 departamente konkretisht:, dhe 2 qendra kerkimi ne rang institucioni te cilat sherbejne per programet e studimit te ketij fakulteti.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka 15 PAE, nga ku 7 grada/tituj;

<p>përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Shkencave Kompjuterike, i cili ka 18 PAE, nga ku 3 me tituj/grada; - Departamenti i Matematikës , i cili ka 15 PAE, nga ku 8 me grada/tituj;
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për këtë MP, janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregulloren e Fakultetit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave” Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, pranë UAMD, ka në përbërje të tij 15 personel akademik efektiv(PAE), nga të cilët 7 me gradën Dr.</p> <p>Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave” .Përsa më sipër GVJ konstaton se të dy njësitë kryesore plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion por edhe nga dokumentacioni i depozituar, konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit MP “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes”, angazhon personelin akademik ndihmës te nevojshëm për realizimin e praktikave, nisur edhe nga numri i vogël i deritanishëm i studentëve. GVJ konstatoi nga takimi me studentët, se institucioni angazhon personel akademik ndihmës të mjaftueshëm, të cilët asistojnë studentët si dhe facilitojnë përmbushjen e këtyre detyrimeve. Referuar dokumentit (<i>Aneks 15. Personeli akademik në FTI</i>) rezultojnë 5 staf ndihmës akademik në rang fakulteti.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programi i studimit MP “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes”, ka të përcaktuar në rregulloren e programit emertimin e koordinitorit të programit. (<i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i>) Nga informacioni i siguruar nga RVB si dhe nga vizita në institucion, rezulton se koordinatori i MP, është Dr. Eris Zeqo, Zv. Dekani i Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p> <p><i>GVJ rekomadon që koordinatori i programit, në këtë rast edhe Zv. Dekani i Fakultetit, të raportojë periodikisht për ecurinë e MP dhe të dokumentojë çdo informacion që lidhet</i></p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë</p>	<p><i>edhe Zv. Dekani i Fakultetit, të raportojë periodikisht për ecurinë e MP dhe të dokumentojë çdo informacion që lidhet</i></p>

periodike te drejtuesi i njesisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	<i>me programin e studimit, me qëllim adresimin zgjidhjen e problematikave të identifikuara për të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin e studimit MP “Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes”, njësia kryesore dhe ajo bazë kanë informacionin e duhur për organizimin e këtij masteri, si rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve. Referuar planit mësimor, konstatohet se programi është i organizuar në lëndë, të ndara sipas kategorive që përmban udhëzimi 41 i MASR.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda zhvillohet. Kohështrirja e programit është një vit akademik me dy semestra. Studenti në përfundim merr 60 kredite ECTS.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Referuar dokumentit (<i>Aneks 30. Plani mesimor MP Sistemet ERP</i>), konstatohet se ka informacion të plotë për ndarjen e cdo lënde në komponentët leksion / seminar, orët në auditor/jashtë auditorit, dhe kreditet për cdo aktivitet. Plani mesimor i nenshtrohet ndryshimeve periodike, në mënyrë që të përshtatet me bazën ligjore për nivelin e krediteve, por mbi te gjitha për përbërjen e cdo kategorie sipas VKM 41. Referuar dokumentit (<i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP</i>), rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara menyrat e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral. Skema e vlerësimit për çdo komponentë të
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	

	<p>kontrollit të dijës është e ndryshme në lëndë të ndryshme. Kështu në shumicën e lendeve skema e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare 20 pikë; - Kontrolli i ndërmjetëm 20 pikë; - Detyra e kursit 10 pikë; - Provimi përfundimtar 50 pikë; <p>GVJ është e mendimit se të dyja këto menyrë vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke përdorur forma alternative vlerësimi të duhurat për një mjedis heterogjen studentësh dhe duke i shërbyer formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.pdf</i> <i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP.pdf</i> <i>Aneks 12. CV e stafit akademik të MP Sistemet ERP.pdf</i> <i>Aneks 13. Tituj-gradat e personelit akademik.pdf</i> <i>Aneks 14. CV e stafit ndihmës akademik MP Sistemet ERP.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit si edhe në dokumentet e tjera rregullatore të UAMD, përcaktohen me hollësi kriteret e transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve si edhe proceset që lidhen me to.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për formatet e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e Titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Megjithatë modeli që përdoret për hartimin e tyre, është bazuar në modelin e përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca no.2).</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP.pdf</i> <i>Aneks 12. CV e stafit akademik të MP Sistemet ERP.pdf</i> <i>Aneks 13. Tituj-gradat e personelit akademik.pdf</i> <i>Aneks 14. CV e stafit ndihmës akademik MP Sistemet ERP.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion dhe takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë</p>

përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	përgjegjëse, rezulton se program i studimit, nuk ka ndryshuar kjo për shkak të kohës së shkurtër të hapjes por, <i>GVJ rekomandon që plani mësimor në të ardhmen, t'i nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme ndryshimeve, me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore por edhe me kërkesat e një tregu pune dinamik si dhe për të reflektuar edhe rekomandime të ekspertëve të jshtëm, apo të studentëve si dhe të bizneseve partnere.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrít Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të kësaj pike përcaktohet se programet master profesional organizohen me 60 ose me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është një vit ose dy vite akademike.</p> <p>Programi MP në ERP përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 60 Kredite; - Orë total 1500, 600 orë në auditor/900 orë jashtë auditorit; - Cdo semestër ka 750 orë, 300 orë në auditor, 450 orë jashtë auditorit; - 20 Orë/ javë semestri parë (15 jave), 22 orë/javë semestri i dytë (10 jave); <p>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim	GVJ është e mendimit se programi ka përputhshmëri, midis emërtimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat do të mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe për punësimin e studentëve që vazhdojnë

<p>të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>këtë program studimi në përthje me emërtesën e programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Ai synon të plotësojë nevojat e tregut të punës për specialistë në fushën e planifikimit të burimeve të ndërmarrjes. Programi i studimit është hartuar duke pasur parasysh njohuritë bazë shkencore të fushës së studimit në Teknologji Informacioni- Ekonomi.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi ka një shpërndarje të studjuar të ngarkesës në dy semestra akademike, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ky program ka për qëllim t'u mësojë studentëve kombinimin e dijeve teorike me aftësi konkrete, si dhe aftësinë për të zbatuar në praktikë koncepte abstrakte teorike, në mënyrë që të jenë të aftë të përshtaten, të orientohen, dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të lirë.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>Objektivat e programit janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përgatisë studentët që të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale në fushën e Sistemeve të Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes; - Të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, të cilët do të jenë në gjendje ti aplikojnë këto njohuri të programeve kompjuterike në sipërmarrje të vogla dhe të mesme; <p>GVJ konstaton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objektivat dhe rezultatet e pritshme, përshtaten me nivelin e masterit profesional si dhe integrimin e lëndëve të sistemeve ERP, bëjnë që objektivat të jenë të arritshme; 2. forcojnë bërthamën e lëndëve karakterizuese të programit të studimit dhe rrisin përputshmërinë me emërtimin e diplomës që ky program master lëshon; <p>GVJ për ngarkesën në kredite dhe raportin leksion /seminar gjykon se është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në</p>	<p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP.</i>), raporti leksion/seminar mundëson përforcimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre nga studentët. Gjithashtu referuar syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra, raste studimore me fokusin e lidhjes së teorisë me praktikën, duke i shërbyer mobilitetit dhe punësimin më të</p>

përfundim të studimeve.	mirë të studimeve në sajë të aftësive praktike më të mira në përfundim të studimeve.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se të gjitha, lëndët kanë literaturën e 5 viteve të fundit.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	GVJ është e mendimit që përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e ERP. Referuar RVB kurrikula është e fokusuar në kërkesat e tregut dhe përditësohet bazuar në kërkesat e biznesit dhe në bashkëpunim me ekspertët e huaj që ndihmojnë në zbatimin e këtij programi. Ajo do të formojë specialistë të aftë, të cilët do të jenë në gjendje të aplikojnë këto njohuri të programeve kompjuterike në sipërmarrje të vogla dhe të mesme. Studentët që të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale në fushën e Sistemeve të Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes.			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Organizimi i lendeve në programin e studimit, duke u mbështetur në detyrat individuale, rastet studimore si dhe diskutimeve, i shërben potencialisht sigurimit të aftësive, kompetencave dhe formimit të thelluar profesional, por natyrisht numri shumë i vogël i studentëve është një sfidë për stafin akademik dhe për student e programit, sepse nuk krijon mundësi për detyra komplekse, detyra grupi dhe diskutime.			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ sic është shprehur edhe më sipër, rekomandon që: <i>programi i studimit në mënyrë që të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet kompetencave të fituara, të përshtatet në vazhdimësi dhe të promovohet dhe në degë të tjera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe

profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program, është me tituj ose gradë shkencore, dhe konkretisht, i përkasin kategorisë profesor dhe kategorisë “Doktor i shkencave”. Përsa më sipër, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet përmbushin kërkesat ligjore në fuqi përkat kualifikimit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar dokumentave të DVV dhe dokumentave shtesë që u kërkuan gjatë vizitës, konstatoi se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për dy vitet akademike është:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 7 pedagogë gjithsej, të gjithë personel akademik efektiv (PAE), nga ku 6 me tituj/gradë. Mbulimi i programit në përqindje është 100% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 6 pedagogë gjithsej, të gjithë personel akademik efektiv (PAE), nga ku 4 me tituj/gradë. Mbulimi i programit në përqindje është 100% PAE.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Duke iu referuar mbulimit të krediteve, rezulton se 100% e krediteve mbulohe nga stafi efektiv. Referuar CV të stafit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, GVJ është e mendimit se stafi akademik i përfshirë në program, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, titull akademik dhe/ose gradë shkencore si dhe eksperiencën e duhur për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Referuar CV-ve të stafit, rezulton se fusha akademike kërkimore shkencore e përgjithshme dhe specifike janë në përputhje me natyrën e lëndëve që ata mbulojnë.</p> <p><i>Aneks 12. CV e stafit akademik të MP Sistemet ERP</i></p> <p><i>Aneks 13. Tituj-gradë të personelit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 14. CV e stafit ndihmës akademik MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>GVJ konstatoi se Fakulteti i Teknologjise se Informacionit, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione e organizata të biznesit, por sugjeron:</p> <p><i>që në këto marrëveshje ose të tjera që institucioni do të lidhë në të ardhmen, të parashikohet në mënyrë eksplicite, vendosja</i></p>

<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p><i>në dispozicion e stafit të duhur për instruktimin e studentëve për realizimin e temës së diplomës.</i></p> <p><i>Aneks 31. Trajnime FTI - Crstal System.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se personeli ndihmës mësimor shkencor është i angazhuar për realizimin e orëve mësimore, mirëmbajtjen e laboratorëve, funksionimin e bibliotekës etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ky plan mësimor është ndërtuar, për të rritur përputhshmërinë me kërkesat e tregut të punës. Ky program ka vetëm një vit që është hapur, dhe nuk patur ndryshime në kurikul. Institucioni ka realizuar një studim të tregut të punës.</p> <p><i>(Aneks 10. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së MP Sistemet ERP)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen</p>	<p>UAMD, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, synon të sigurojë informacion për efektivitetin dhe mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Referuar takimit me studentët, me stafin akademik si dhe me drejtuesit, këto pyetësorë drejtohen për stafin akademik të përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ është e mendimit që pyetësori për studentët të përmbajë</i></p>

nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<i>edhe një seksion pyetjesh për përmirësimin e programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.</i> <i>Gjithashtu sugjerohen përfshirje edhe të metodave të tjera alternative me proaktive për të siguruar perceptimin e studentit në lidhje me programin të studimit, si organizimin e fokus grupeve apo tryezave të rrumbullakta me pjesëmarrjen e studentëve.</i>			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Pranë UAMD, është ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës, GVJ konstatoi që institucioni nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës ka krijuar rrjetin alumni, i cili mban kontakte të vazhdueshme me ish -studentët e programit dhe të fakultetit, për të siguruar prej tyre informacion në lidhje me punësimin por edhe përmirësimin e programit të studimit.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	GVJ gjatë vizitës në institucion siguroi informacion për institucionet me të cilat UAMD ka bashkëpunim dhe marrëveshje, dhe konstatoi përditësime të programit të studimit, të sugjeruara nga ky bashkëpunim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e informacionit

<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>të ASCAL, nga takimet me drejtues të njësive kryesore dhe bazë, rezulton se UAMD trajnon dhe udhëzon stafin për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit.</p> <p>UAMD zhvillon trajnime të ndryshme të vazhdueshme lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur përdorimin e metodave të reja sipas specifikave të fushës përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë dhe NJSBC, zhvillojnë mekanizma monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse, duke përcaktuar edhe objektivat për të ardhmen. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në pyetësorët e studentëve që organizohen dy here në vit, vlerësimi i kontrollit në orën e mësimi të pedagogut nga ana e drejtuesëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimi të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultoi se studentët para përfundimit të cdo semestri përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njësive kryesore dhe asaj bazë janë të angazhuar për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet metodave të cilat janë të sanksionuara dhe në rregulloren e UAMD.</p> <p><i>(Aneks 3. Rregullore UAMD)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimi.</p>	<p>NJSBC si njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në UAMD, realizon sondazhet e studentëve dhe harton raportin vjetor me gjetjet e këtij studimi i cili prezantohet në senatin akademik të UAMD, gjithashtu ky raport i komunikohet drejtuesve të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimi dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion rezulton se UAMD ka organizuar leksione të hapura për të gjithë stafin akademik, e me fokus dy drejtime kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkëmbimin e përvojës në organizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur në praktikat më të mira; 2. Njohjen më mirë me elementët e didaktikës dhe psikologjisë. Këto leksione cilësohen të jenë të rëndësishme pasi mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndërmjet brezave të ndryshëm; 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Referuar rregullores së programit, Syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me staf dhe studentë, GVJ konstaton se në program studimi, përdoren forma alternative leksione/seminare/ detyra grupi/detyra kursi. Mes specifikimeve që ka rregullorja dhe përcaktimeve të këtyre formave në syllabus dhe në aplikim, GVJ konstaton se ka përputhshmëri.</p> <p>Referuar Planit Mësimor, rezulton se cdo lëndë e semestrit të parë zhvillohet në ngarkesën 3 leksione/javë dhe 6 kredite. Për cdo lëndë të semestrit të parë realizohen 48 ore leksione në auditor dhe 102 orë punë e pavarur jashtë auditorit. 3 Lëndë të semestrit të dytë zhvillohen në ngarkesën 3 leksione/javë dhe kanë nga 6 kredite, 48 ore leksion në auditor, dhe 102 orë jashtë auditorit. Këto forma leksione/seminare dhe praktikë mësimore janë të miratura nga institucioni në planin mësimor.</p> <p><i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP.</i></p> <p><i>Aneks 30. Plani mesimor MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Referuar takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit rezulton se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, të kontrollit të dijës dhe duke qenë proaktiv për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Kështu u konstatua nga takimi me studentët se përveç leksioneve, gjatë seminareve përpos kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve, diskutimeve, aplikohen edhe: a) rastet studimore, b) detyrat individuale, c) analizat krahasuese mes praktikave më të mira në kontekstin e bizneseve shqiptare.</p> <p><i>GVJ rekomandon që këto forma alternative të jenë më të formalizuara dhe të jenë të pasqyruara edhe në syllabuset e lëndëve, duke krijuar mundësinë edhe për follow-up e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se UAMD, me synimin e</p>

<p>personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>përmirësimin të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka zhvilluar leksione të hapura apo trajnime për stafin akademik. Referuar RVB fakulteti në bashkëpunim me Crystal System ofron për cdo student dhe anëtarët e stafit akademik kushte optimal për të praktikuar të gjithë format e mësimdhënies, si dhe për të eksperimentuar metoda alternative të mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ, referuar CV, fushave të ekspertizës, eksperiencës së stafit, takimeve me studentët dhe perceptimeve të tyre, është i mendimit se, stafi akademik i programit zotëron kompetencat e duhura të mësimdhënies. Stafi është me tituj dhe grada shkencore nga të cilët 1 (një) i kategorisë Prof.Asoc., 5 (pesë) me gradën Dr. Institucioni ka në qëndër të vëmendjes përfshirjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik dhe të metodave të mësimdhënies. UAMD nëpërmjet anketave të studentëve, degjimit në auditor etj, paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave të studentëve, synon vlerësimin dhe vendos objektivat për përmirësimin e metodave didaktike.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p><i>GVJ sygjeron që ky proces të jetë më i formalizuar dhe të dokumentohet.</i></p> <p>Informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion dëshmon se stafi akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për të ndërthurur teorinë me praktikën, por edhe për të rritur atraktivitetin e orëve të mësimin.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve, në kete program studimi rrit mundësinë e fleksibilitetit në përdorimin e metodave alternative, por nga ana tjetër krijon mundësinë për më tepër detyra individuale sesa grupi, duke inkurajuar autonominë e tyre, por duke pasur në fokus respektimin e rregullores si dhe te përcaktimeve në syllabus.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e

logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita në institucion u konstatua që e gjithë infrastruktura e cila ishte në funksion jo vetëm të procesit mësimor, plotëson të gjitha standardet. Të gjitha sallat e leksioneve/ seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme, duke pasur parasysh edhe numrin e vogël të të studentëve. Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se godina permban shume salla për leksione, shtatë klasa per seminare dhe 2 laboratore, biblioteka, librari, një salle informatike e cila shërben dhe si sallë interneti për të gjithë studentët e UAMD. Këto ambiente rezultojnë të jenë në standardet normale të mirëmbajtjes dhe kushteve higjieno-sanitare.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, white bord videoprojektor. Gjithashtu ambientet e bibliotekës duhet të jenë më të përshtatshme dhe më funksionale. Pajisja e saj me kompjutera, me më tepër poste ulje, me mundësinë e aksesimit elektronik të një data base librash/revistash, kondicioner etj. duhet të konsiderohen nga ana e institucionit.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Referuar RVB, dhe informacionit të siguruar në institucion, UAMD përdor sistem informacioni të integruar, i cili krijon mundësi për një manaxhim të integruar të MOODLE. <i>Sugjerohet që njësia bazë, stafi akademik i programit të studimit dhe stafi administrativ të intensifikojë përdorimin e këtij sistemi për të shfrytëzuar potencialet që ai ofron dhe që do t'i shërbejë proceseve efektive mësimore, por edhe dokumentimit të tyre.</i>
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se të gjitha lëndët, kanë literaturën e 5 viteve të fundit. Ndërkohë referuar vizitës në bibliotekën e institucionit, konstatohet se numri i librave (fizike) është i vogël sidomos në literaturë ndihmëse, ndërkohë që nuk u identifikuan burime alternative si biblioteka dixhitale. Për sa më sipër, GVJ është e mendimit, <i>se institucioni duhet</i>

	<i>të ndërmarrë iniciativa për shtimin e titujve për literaturën bazë dhe ndihmëse, periodikëve, revistave në hard copy, por edhe mundësinë e abonimit në një bibliotekë dixhitale.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	GVJ është e mendimit se biblioteka e institucionit, <i>duhet të azhurnohet me titujt e botimeve të fundit, të shtojë numrin e kopjeve në bibliotekë si dhe të ketë një organizim më efektiv si dhe hapësira më komode e motivuese për studentët.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi ekzistencën e disa librarive on-line, stafi akademik i udhëzon studentët të aksesojnë materiale të ndryshme në mbështetje të procesit mësimor. <i>GVJ sugjeron që institucioni të krijojë mundësinë e rregjistrimit në një bibliotekë on-line, të aksesueshme së paku në ambientet e institucionit dhe mbi të gjitha në bibliotekë.</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 2 laboratorë. Nga takimi me studentët konstatohet se studentët mund t'i shfrytëzojnë këto ambiente, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës etj.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga informacioni i siguruar nga sekretaria e institucionit, studentët e programit dhe stafi akademik kanë mundësinë që nëpërmjet kredencialeve personale të aksesojnë dokumentacionin elektronik, të uploadojnë/ downloadojnë leksionet, vlerësimet individuale etj. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se programet kompjuterike iu janë përshtatur këtij programi studimi duke instaluar programe aplikative që kërkohen nga departamenti dhe janë vënë në dispozicion nga kompanite private.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	UAMD ka krijuar mundësinë e pajisjes me mjete moderne për t'u përdorur nga pedagogët dhe studentet për të perfeksionuar sistemet e komunikimit të brendshëm me mjete bashkëkohore.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me stafin akademik, studentët si dhe dokumentacioni i depozituar në sistemin e ASCAL, Departamenti i Teknologjise se

<p>diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Informacionit, informon studentët e vitit të fundit, për fushat e studimit dhe tematikat orientuese për tezat e diplomës. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës.</p> <p>Studenti gjithashtu ka lirinë të propozojë vetë një tezë diplome se bashku me udhëheqesin përkatës. Duke qenë se numri i studentëve është i vogël, krijon mundësinë për të respektuar zgjedhjet e tyre dhe për t'i udhëhequr ata drejt realizimit të punimeve cilësore.</p> <p><i>(Aneks 3. Rregullore UAMD).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UAMD ka ngritur strukturën e NJSBC, e cila ka funksion kryesor sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo njësi është në nivel institucional, realizon pyetësorët e studentëve, perpunimin dhe analizën e tyre, si dhe harton raportin në nivel institucional, të cilin e paraqet në senat.</p> <p>GVJ konsultoi raportin vjetor për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor i cili konsiderohet një formë që i shërben plotësisht të këtij kriteri, por GVJ është e mendimit se: <i>NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.</i></p> <p><i>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në</p>	<p>Përcaktuar edhe nga Ligji i Arsimit të Lartë, Departamenti që ofronte dhe programin e studimit ishte përgjegjës për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofronte. Njësia bazë mbështet dhe nxit proceset, të cilat</p>

programet e studimit që ofron.	synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ konstaton se njësia bazë inicion procese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohen trajnime të realizuara, mbështetur në burime të brendshme/ të jashtme për implementimin e metodave të reja.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Zhvillimi i trajnimeve për metodat e mësimdhënies, është tregues i nxitjes së njësisë bazë për përdorimin e metodave të reja. Njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga takimi me GVB, me përgjegjësin e departamentit, rezulton se njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe jep informacion të detajuar për cilësinë e programit të studimeve dhe përmbajtjen e tij ndaj studenteve. Secili pedagog i programit të studimit në fillim të semestrit rishikon syllabus-in e lëndës, i cili më pas shqyrtohet nga përgjegjësi i gruplëndëve dhe përgjegjësi i departamentit për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.
	<p>Kualifikimi në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për përmirësimin e mësimdhënies në këtë program studimi është nën mbikqyrjen e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Nga takimet me stafin dhe me titullarët u vu re një “kontroll” i vazhdueshëm por i nevojshëm i stafit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies si dhe për përputhjen e tij me objektivat e programit të studimit. I gjithë stafi, dhe vecanërisht ai i ri, trajnohet me mënyrën e funksionimit të cilësisë. Gjithashtu stafi i ri në mësimdhënie mbikqyret nga titullarët të lëndës dhe të institucionit edhe në auditor. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Mobiliteti i stafit akademik realizohet në kuadër të: projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Tempus, Erasmus Mundus, Erasmus+ të Komisionit Europian.</p> <p>Personeli akademik i programit, nisur nga CV e tyre merr pjesë me referime në konferenca shkencore dhe botime në revista shkencore. Qasja e institucionit për kërkimin shkencor mendojmë se duhet të jetë më proaktive.</p>

	<i>Aneks 12. CV e stafit akademik të MP Sistemet ERP</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se personeli ndihmës akademik, është i angazhuar për të kryer detyrat, angazhimi i pedagogëve nga Fakulteti i Biznesit dhe bashkëpunimi në vazhdimësi për të siguruar nevojat e programit të studimit është një element pozitiv për këtë program studimi.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Sipas RVB-së, Përgjegjësit e departamenteve me anë të verifikimeve në auditorët e mësimdhënies apo takimeve specifike, vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies duke raportuar më tej pranë dekanit, por GVJ është e mendimit, se për përmbushjen e këtij kriteri, UAMD duhet të ketë parasysh për të ardhmen, testimin e metodave të reja duke marrë një feedback për pritshmëritë dhe efektivitetin e këtyre metodave, nga stafi akademik, studentët dhe stafi ndihmës akademik me qëllim ndërmarrjen e veprimeve rregulluese.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UAMD, angazhon lektorë në procesin mësimor, si lektorë të ftuar apo kërkues shkencorë jashtë institucionit për shkëmbim të ideve dhe eksperiencave. <i>Aneks 31. Trajnime FTI - Crstal System.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen	GVJ konstaton se Institucioni ka hartuar dokumente rregullatore transparente që normojnë kriteret, mënyrën e vlerësimit, si edhe njohjen e tyre prej studentëve. Referuar (<i>nenit 68 të rregullores së UAMD</i>), shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 100

publike dhe njihen nga studentët.	<p>pikësh, bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Provimi i ndërmjetëm 40%; - Provimi përfundimtar 50%; - Detyrat, projektet, esetë 10%; <p>GVJ është e mendimit se këto skema vlerësimi krijojnë mundësi të nxitjes dhe aktivizimit të studentëve gjatë gjithë semestrit, duke përdorur forma alternative vlerësimi të përshtatshme për një mjedis heterogjen studentësh në funksion të formësimit dhe përvetësimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP</i></p>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>GVJ konstaton nga takimi me studentët dhe stafin akademik se ata informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për, programin e lëndës, format alternative të vlerësimit, dhe detyrimet që studentët kanë.</p> <p>Gjithashtu referuar edhe syllabuseve që institucioni ka dorëzuar, konstatohet se pedagogët që mbulojnë disiplinat e këtij programi kanë të pasqyruara qartë në syllabuse dhe zbatojnë formate të qarta të procesit të vlerësimit të vazhduar dhe të vlerësimit përmbledhës.</p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të diversifikuara duke iu dhënë mundësi të gjithë studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i	Është në politikën e institucionit vlerësimi i përgatitjes

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>akademike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit shkollor. GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është gjithë semestral, me komponente të tillë si detyra individuale, detyra kursi, mid term dhe provimi final. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final. Në disa prej lëndëve studentët bëjnë testime on-line nëpërmjet platformave elektronike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezultojnë se testimi përfundimtar realizohet nga një komision, i cili rezultojnë se ka jo më pak se 2 anëtarë, këto komisione miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Në komision njëri nga anëtarët është titullari i lëndës. Pavarësisht kësaj, institucioni nuk vendosi në dispozicion të GVJ, dokumentacion për të vërtetuar se kjo praktikë ndiqej.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar RVB, si dhe takimeve në institucion, konstatojmë se kjo praktikë nuk aplikohet si rregull në zhvillimin e provimeve. Kur shikohet e arsyeshme dekanati mund të vendosë që në sezone të caktuara provimet të zhvillohen me sekretim. Në këto raste administrimi i tyre bëhet nga sekretaria mësimore e fakultetit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit rezultojnë të jenë transparente, ku stafi akademik realizojnë vlerësim të arsyetuar të të gjithë komponentëve të parashikuar në detyrimet akademike. Studentët kanë të drejtë të marrin feedback dhe të konsultojnë vlerësimin e tezave të tyre, si mundësi për përmirësimin e rezultatit të tyre në të ardhmen</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregullat e zhvillimit të kontrolleve të dijes përcaktohen në dokumentat përkatëse të institucionit, referuar (<i>nenit 70 të rregullores së institucionit</i>), janë të parashikuara rregullat e provimit. Në rast se studenti thyen rregullat e provimit studenti ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi nga personeli akademik, të cilit i bashkangjitet provimi që vlerësohet me 0 pikë. Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni për të shmangur kopjimin, ndërkohë për plagjaturën ende nuk ka një program.</p>

	<i>Sugjerohet që UAMD të investojë në sigurimin e një program antiplagjature.</i>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga takimi me studentët e ketij program studimi, na rezultoi, se vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregullores. Në seancën e fundit mësimore studentët informohen për vlerësimet gjatë semestrit. Këto vlerësime janë komponentë të vlerësimit final. Rezultatet duhet të nxirren brenda 10 ditëve kalendarike, që nga data e zhvillimit të provimit. Studentët i aksesojnë rezultatet /vlerësimet e tyre nëpërmjet sistemit. Nga ky takim për GVJ, rezulton se perceptimi i tyre ishte për vlerësim mbi bazë të meritës.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar dokumentacionit të depozituar të UAMD por edhe takimeve me studentët e programit, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me menyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet/mungesat në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Në rast se studenti edhe pas marrjes së rezultateve nuk është i bindur për saktësinë e vlerësimit atëherë ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë në dekanat një kërkesë me shkrim për rishikim të vlerësimit të provimit.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ refeuar (<i>nenit 71 të rregullores së UAMD-së</i>), konstaton se është parashikuar ankimimi i provimeve. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet dekanit, jo më vonë se 3 ditë nga publikimi i rezultateve. Dekani kur e sheh të arsyeshme ja kalon për shqyrtim shefit të departamentit, i cili vë në dijeni personelin akademik pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te dekani një relacion shpjegues. Në bazë të këtij relacioni dekani vendos për miratim ose refuzim të kërkesës së studentit. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahen në dekanat. <i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i> <i>Aneks 3. Rregullore UAMD</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve në module të vecanta të këtyre sistemeve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit përmban lëndë të tilla të cilat ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të vecanta të studentëve, në fushën e teknologjisë së informacionit
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me studentët e programit, në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, sigurohet informacion i përgjithshëm për cilësinë e aftësive që ata fitojnë. <i>GVJ sugjeron përfshirjen në pyetësorët e studentëve, edhe të pyetjeve specifike rreth kompetencave të fituara nga studentët për të siguruar informacion rreth realizimit të objektivave .</i>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, në seancën e fundit të semestrit cdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë. Gjithashtu, pedagogët ishin në dispozicion të studentëve sipas një kalendari paraprak për konsultat përpara provimit.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstaton, se studentët e programit, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës, sic është seminari me temë Arsimi dhe kërkimi shencor në bashkëpunim me Zyrën e Erasmusit. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në

	orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Referuar programit të studimit dhe syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezulton se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Referuar syllabuseve të lëndëve dhe informacionit në takimet me studentët dhe me stafin e programit, GVJ konstaton se pedagogët inkurajojnë studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi për adresimin e problemeve në të cilat ndeshen bizneset në aspektin manaxherial dhe jo vetëm. Pavarësisht mbështetjes dhe suportit të studentëve, duke qenë se numri i studentëve është shumë i vogël, mbetet e vështirë organizimi i detyrave të grupit dhe nxitja e diskutimeve dhe debateve nga kënvështrime të ndryshme			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	GVJ është i mendimit se gjatë procesit mësimor, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit lidhur me sistemet ERP.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pavarësisht mbështetjes së stafit për përfshirjen e studentëve, roli kryesor duhet të jetë i institucionit, i cili duhet të sigurojë informacionin për alternativat e përfshirjes, motivimin dhe mbështetjen financiare për studentët. GVJ nga vizita në institucion nuk siguroi asnjë praktikë të përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton bashkëpunime mes UAMD dhe institucioneve të ndryshme, të cilat synojnë përfshirjen e studentëve në intershipe, për të rritur mundësinë e punësimit të tyre. Nga takimi me stafin akademik, stafi i mentoron studentët në praktikë, për të orientuar ata të aplikojnë njohuritë teorike të marra në auditor, në mjedise reale biznesi. <i>Aneks 31. Trajnime FTI - Crstal System.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedis brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga sa rezultoi nga vizita në institucion si dhe nga takimet me studentët, kryesisht praktikat profesionale zhvillohen në mjedis jashtë fakultetit kryesisht pranë bizneseve me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi ose në biznese që studentët i kanë siguruar individualisht me miratimin e institucionit. Përsa i përket praktikave laboratorike në lëndë të caktuara ato zhvillohen në mjediset e institucionit, në laboratorin e teknologjisë informative, i cili disponon infrastrukturën dhe kapacitetin e duhur të posteve për të zhvilluar procese normale.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfundimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ konstatoi se insitucioni për praktikat profesionale në program, ka vendosur lidhje bashkëpunimi me një numër institucionesh dhe subjektsh private që plotësojnë kushtet e kërkuara nga natyra e PS. Përveç infrastrukturës materiale që ofrojnë subjektet ku realizohen praktikat mësimore ata angazhojnë edhe mentorues që në bashkëpunim me pedagogët dhe procedurat e vlerësimit të praktikave sipas rregullores së programit, të realizojnë qëllimin e tyre. <i>Aneks 31. Trajnime FTI - Crstal System.</i>			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Referuar planit mësimor, nuk vlerësohet me notë, por me statusin 'Fiton' ose "Nuk fiton". Kjo praktikë rezulton të dokumentohet dhe studenti para mbrojtjes së saj para komisionit duhet të depozitojë vërtetimin e zhvillimit të praktikës si dhe relacionin e praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton	Referuar (<i>nenit 16 të rregullores së programit të studimit</i>),

<p>procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>rezulton se Institucioni ka parashikuar procedurën e diplomimit. Studenti duhet të mbrojë provimin e diplomimit ose punim diplome për studentët me mesatare mbi 8. Për provimin/punimin e diplomës janë parashikuar 12 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së provimit/punimit të diplomës studentit duhet të ketë fituar 48 kreditet e nevojshme.</p> <p>Institucioni paraqet nëpërmjet akteve rregullatore në mënyrë të detajuar cdo procedurë që ndiqet që nga faza e parë deri në fazën finale të mbrojtjes së diplomës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ konstaton se, studentët kanë provim final, mbrojtjen e punimit të diplomës para komisionit të posaçëm, e cila synon integrimin e të gjithë njohurive të marra gjatë studimeve master në një fushë/temë të caktuar.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Referuar rregullores si dhe takimit me studentët dhe stafin akademik të programit, departamenti bën të njohura për studentët temat ose fushat e studimit për përgatitjen e punimeve të diplomave. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës. Departamenti i shqyrton ato dhe cakton udhëheqësit nisur nga specialiteti dhe kualifikimi i personelit akademik të tij, duke qenë se janë numër i vogël studentësh, preferencat e tyre përgjithësisht merren parasysh.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se fusha e sistemeve të ndërmarrjes ku përgjithësisht janë mundësitë për realizimin e temave të detyrave të lendeve të ndryshme, nuk kërkon hulumtime empirike në terren dhe jashtë ambienteve të UAMD, pra institucioni ka kapacitete për të asistuar studentët në përpunimet statistikore kompjuterike që mund të realizojnë.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Stafi akademik ka të planifikuar disa seanca sipas një plani, për të asistuar studentët, për strukturën e punimit, metodologjinë, instrumentet e përdorur, për punimin e tyre si dhe mënyrën e shkrimit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me</p>	<p>Referuar RVB, ky program studimi si detyrim përmbyllës parashikon provim përfundimtar diplomimi, i cili vlerësohet</p>

notë.	me notë bazuar në pikët e fituara nga studenti dhe me të njëjtën shkallë vlerësimi si lëndët e tjera.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Ashtu sic është e parashikuar në nenin 90 të rregullores së UAMD-së, studenti në përfundim të programit ka të drejtë të pajiset me diplomën, dhe suplementin e saj. Forma e diplomës dhe procedurat për regjistrim janë të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, për këtë program studimi, konkretisht diploma është e miratuar me Urdhër Nr.128, datë 05.06.2019 të QSHA.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në rregulloren e Fakultetit, studenti më kërkesë të tij, ka të drejtën të pajiset me dokumentacionin e plotë rreth programit të studimit, si plan mësimor, syllabuse, vertetim notash etj. Pas mbarimit të studimeve dhe pajisjes me diplomë, dokumentet dorëzohen në protokoll – arkiv. Procedurat për ruajtjen dhe hyrje/daljet e dokumentacioneve janë të paraqitura në ‘Rregulloren për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit’.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Dosjet e studentëve të vëna në dispozicion të GVJ gjatë takimit, rezultuan se kishin informacion të plotë, si deklaratën personale, diploma dhe listë notash të shkollës së mesme të noterizuar, diploma dhe listë notash të bachelorit të noterizuar, fotografi personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe	GVJ konstatoi se UAMD, në lidhje me MP, disponon të

48 Ek

<p>përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>dhënat për çdo semestër, për çdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij. Personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit ka gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.</p> <p>Nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, rezulton se në dosjet e perzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, librezë pune, kontrat e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj</p>			
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar informacionit të konsultuar në sistemin AMS të ASCAL, rezulton se UAMD, ka një tërësi rregulloresh dhe dokumentash të mbështetur në bazën ligjore në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik ndërkohë GVJ gjatë vizitës në institucion me stafin e burimeve njerëzore, nuk siguroi një praktikë konkrete, të zbatimit të këtyre procedurave.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Stafi i burimeve njerëzore shprehet se ata zbatojnë rregulloret, përzgjidhen më të mirët, pranojnë që këto procedura nuk i kanë të dokumentuara dhe kanë referencat dokumentare që deshmojnë procesin e rekrutimit, kështu që edhe GVJ mund të shprehet pozitivisht por nuk ka pasur praktikat e rekrutimeve për stafin akademik të këtij programi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, konstaton se UAMD ka një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, sipas ligjeve në fuqi por GVJ nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin, kush aplikonte, si bëhej vlerësimi i tyre dhe si përzgjidhej apo nëse bëheshin publike këto procedura GVJ nuk konstatoi mekanizma të bërjes publike të këtyre kritereve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion, takimeve me grupe të ndryshme të stafëve, GVJ konstaton se UAMD angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UAMD rezulton se mbështet stafin e tij për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat inovative, pjesëmarrjen në konferencat të cilat organizohen, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta.</p> <p><i>Ndërkohë GVJ sugjeron politika më proaktive mbështetje, vendosjen e sistemeve motivuese e stimuluese të pjesëmarrjes në konferenca nderkombëtare prestigjioze apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë.</i></p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga takimet me stafin akademik, rezulton se UAMD, organizon trajnime/ ose leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies. Në faqen e internetit të institucionit pasqyrohen aktivtete që shërbejnë për nxitjen dhe inkurajimin e punës në të ardhmen. Platformën "E-learning", e cila është një metodë inovative ku i krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimi, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike.</p> <p><i>GVJ rekomandon rritjen e mundesimit të kualifikimit të mëtejshëm.</i></p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga i gjithë dokumentacioni është evidente që Institucioni dëshmon një angazhim të plotë të burimeve njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="576 1910 767 2009">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="767 1910 959 2009">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="959 1910 1150 2009">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1150 1910 1382 2009">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UAMD siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme e pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Rezulton se ka sasi të mjaftueshme, laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimin të programit të studimit. Nga këto statistika identifikohet se UAMD, disponon auditorë mësimore që kanë kapacitet prej 100 -120 vende të ulura në një sipërfaqe prej mëse 100²-110² secila; pesëmbëdhjetë (15) sallat e seminareve, kanë kapacitet prej 30-45 vende ulëse, me një sipërfaqe prej 35²-55² secila. UAMD është një ndërtesë 2 kateshe buze detit.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 2 laboratorë. Nga takimi me studentët konstatohet se studentët mund ti shfrytëzojnë këto ambiente, në shërbim të detyrave të kursit, temës së diplomës</p> <p>Gjatë vizitës në institucion të GVJ, ndër laboratorët që UAMD disponon, njëri prej tyre rezultoi laboartori i Informatikës, i cili ka pajisjet e duhura hardwerike dhe softwerike që studentëve ju nevojiten.</p> <p><i>Aneks 36. Laborator MP Sistemet MRP.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të</p>	

moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>Studentët kanë mundësi që të zhvillojnë aktivitete praktike në laboratorët që vetë institucioni posedon dhe që GVJ konstaton se kanë kapacitete pritëse të mjaftueshme</p> <p>Ndërkohë praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve me të cilat UAMD ka marreveshje.</p> <p><i>Memorandum UAMD - Crystal System</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, UAMD vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët pavarësisht se PS, ka numër të vogël studentësh.</p> <p><i>GVJ sugjeron zgjerim të hapësirës së bibliotekës dhe përmirësim të kushteve të saj infrastrukturale, numer fizik postesh, vendosje te PC, kushte ngrohje/ftohje, për të qenë një mjedis më funksional.</i></p>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe	Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një

Handwritten signature/initials

<p>dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe 10 kompjutera për punime dhe kërkime shkencore. Biblioteka digjitale, pajiset vazhdimisht me botime periodike. Biblioteka ka siguruar dhe disa aksesë në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë. <i>GVJ sugjeron që institucioni duhet të krijojë kushte për akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Questia, Social Science Library, Elsevier.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka duhet të jetë pjesë e sistemeve dhe shërbimeve të përbashkëta bibliografike online dhe rrjete ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës të cilat përfaqësojnë një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p> <p>GVJ nuk siguroi të dhëna mbi buxhetin e parashikuar për blerjen e librave, apo për vendimet e marra nga bordi i administrimit mbi propozimet e njëjësive respektive.</p> <p><i>GVJ rekomandon zbatimin e një plani të detajuar të përvitshëm, me propozim nga njësi bazë, për shtimin e fondit të bibliotekës dhe për pasurimin cilësor të saj me literaturë bashkekohore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Pavarësisht se pedagogët e programit të studimit ju rekomandojnë studentëve leximin e artikujve të ndryshëm në internet, GVJ referuar vizitës në bibliotekë, sugjeron pajisjen e saj me kompjutera, me internet, me mundësinë e aksesimit elektronik të një data base librash/revistash për të qenë një ambient që fton e mirëpret studentët edhe në fundjave ku zhvillohen leksionet e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi prezencën e librave dhe literaturës ndihmëse fizike. GVJ sugjeron pajisjen me disa PC të bibliotekës me mundësinë e shfrytëzimit të tyre nga studentët, me programe kompjuterike që inventarizojnë bazën e librave që UAMD disponon, apo që sigurojnë informacion mbi kërkimet elektronike të studentëve për</p>

	literaturë si dhe të pajisjeve të tjera elektronike, skaner, 'all in one', printer, fotokopje etj, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka vihet në dispozicion me oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Oraret janë në fundjave për këtë program studimi. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur. <i>Aneks37. Urdher për funksionimin e bibliotekës në fundjave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ referuar rregullores së UAMD, konstaton se të dhënat në UAMD mbahen në dy forma, regjistrat manualë dhe regjistrat elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit, por GVJ konstatoi një sistem informacioni funksional, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në i cili është pjesë e një sistemi të integruar informacioni në nivel institucional. Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezultoi se zyra e burimeve njerëzore administrojnë të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar takimit me studentët, rezultoi se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për	<i>GVJ sugjeron implementimin e një sistemi informacioni të integruar, ku një prej moduleve të tij të jetë për menaxhimin</i>

të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<i>e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrative, duke nisur që prej procedurave të konurrimit, seleskionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Referuar RVB por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin akademik të përfshirë, rezulton se në institucion, për komunikimin interaktiv të stafit akademik me studentët përdoret LMS (Learning management system) që janë aplikacione në web, të cilat mundësojnë menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor. Një prej tyre është MOODLE. Duke qenë se numri i stafit akademik, joakademik dhe i studentëve është i vogël, deri tani manaxhimi arrin të monitorojë aktivitetin akademik e administrativ, por <i>GVJ rekomandon implementimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit, i cili garanton monitorim dhe siguron raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese, titullarët apo ekspertët e jashtëm.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në këtë mënyrë institucioni do të siguronte një dokumentim dhe formalizim më të mirë të proceseve administrative, për të dëshmuar dhe gjurmuar proceset e realizuara, problem që u identifikua gjatë vizitës në institucion.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	GVJ konstatoi se webi i institucionit është funksional, ai është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Në web GVJ konstatoi të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit syllabuseve etj. www.uamd.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të

GVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se

<p>programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>është Bordi i Administrimit që përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron UAMD nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si edhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore rreth shërbimit të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Bordi i Administrimit siguron qëndrueshmërinë financiare në Institucion, ku si pjesë të planit të tij financiar ka buxhetimin e të ardhurave dhe alokimin e tyre.</p> <p>GVJ rekomandon që në planin për mbështetjen financiare të ketë aktivitete më të detajuara të planifikuara për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ referuar RVB, konstaton se çdo vit institucioni kryen auditim nga organet perkatëse. Raporti i auditit fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Përveç auditimit të jashtëm kryen dhe auditime të brendshme dhe i raportohen Bordit të Administrimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ nuk konstatoi raporte financiare për 3 vitet e shkuara sikunder kriteri 4 kërkon, prandaj GVJ nuk mund të shprehet për këto kriter.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së</p>	<p>GVJ nëpërmjet sistemit AMS, konstatoi se strukturat përkatëse hartojnë pasqyrat financiare vjetore, të cilat sipas RVB dhe takimit me GVB, raportohen në senat dhe në</p>

zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	bordin e Administrimit. GVJ rekomandon gjetjen e mekanizmave për rritjen e numrit të studentëve dhe të të ardhurave për këtë program, për të rritur qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Kriteri 2. Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përcaktimin i kriterëve pranuese të MP në Sistemet ERP, institucioni ndjek të njëjtën praktikë që zbatohet edhe për programet e tjera të studimit. Procedurat dhe kriteret e pranimit në MP janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikatat e institucionit.</p> <p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e FTI dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit</p>

	Akademik të UAMD. <i>Aneks 4. Rregullore FTI.pdf (neni 29, 38, 39)</i>			
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Çdo fillim viti akademik, njësia bazë, në rastin e programit të studimit MP në Sistemet ERP,DTI, propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD-së, bazuar në propozimet e DTI dhe FTI (aneks 4). Kriteret bashkë me vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD.			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në MP në sisteme ERP, pedagogët u shprehën se studentët njoftohen në rrugë zyrtare nëpërmjet publikimeve në faqen elektronike zyrtare të UAMD dhe në rrjete sociale si edhe komunikime informale që pedagogët zhvillojnë me studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik me studentët potencial për të ndjekur këtë program studimi. Në dosjen e programit të studimit në fjalë paraqiten në mënyrë të detajuar, studentët potencialë, objektivat e formimit si edhe punësimi i mundshëm i tyre.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<i>Aneks 4. Rregullore FTI.pdf (neni 29, 38, 39)</i> <i>Aneks 8. Dosja e MP Sistemet ERP</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Masteri Profesional në ERP është projektuar për studentët të cilët kanë përfunduar një program studimi Bachelor ose DIND dhe janë diplomuar në: 1) Sisteme Informacioni 2) Informatikë – Biznesi 3) Informatikë – Ekonomike 4) Shkenca Kompjuterike 5) Informatikë 6) Teknologji Informacioni 5 7) Inxhinieri Informatike 8) Shkenca Ekonomike 9) Financë – Kontabilitet 10) Bankë – Financë 11) Menaxhim – Marketing 12) Administrim Biznesi. Nga takimi i GVJ me koordinatorin e programit u konstatua se studentët kandidatë për këtë program studimi informoheshin në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e pëfituara në përfundim të tij. Zhvillimi i workshopeve nga Crystal System ishte një tjetër mënyrë për të informuar studentët. Po kështu vënia në dispozicion të studentëve të syllabuseve si dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin plotësohej nga stafi i angazhuar në këtë program studimi dhe sekretaria mësimore. Nga sa më sipër GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi. Më konkretisht rregullorja e FTI specifikon procedurat që ndiqen në rastin e njohjes së studimeve të mëparshme.</p> <p><i>Aneks 4. Rregullore FTI.</i></p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Informacioni është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit MP në sisteme ERP. Stafi gjithashtu informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimin.</p> <p><i>Aneks 11. Syllabuset e lëndëve MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studenti njoftohet në lidhje me procedurat e diplomimit, këto kriteret janë të detajuara të rregullorja e programit të studimit, si sa i përket peshës në kredite si dhe numrin e krediteve që studenti duhet të ketë para diplomimit. GVJ sugjeron që për këtë program studimi të hartohen indikatorët të matshëm për vlerësimin e cilësisë së punimit të diplomës.</p> <p><i>Aneks 5. Rregullore MP Sistemet ERP.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm</p>	<p>Nga takimi i realizuar midis GVJ dhe stafit të angazhuar në programin e studimit MP në Sistemet ERP, realizohen disa takime informuese me studentët potencialë për këtë program</p>

dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	studimi. Kjo vjen dhe si nevojë e biznesit për të informuar studentët të cilët më pas do të punësohen prej tij. Megjithatë përtej angazhimit dhe partneritetit me biznesin, <i>GVJ sugjeron që, për të siguruar sukses të programit të studimit në afatin e gjatë, njësitë përgjegjëse për këtë program studimi duhet të intensifikojnë komunikimin e tyre drejt një targeti më të gjerë studentësh.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Studenti mund të terheqë planin mësimor, strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra pranë sekretarisë. Ky informacion publikohet edhe në mediat sociale të UAMD-së. Studentët informohen për strukturën dhe organizimin e studimeve edhe gjatë workshopeve që zhvillohen me biznesin.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmes.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Lidhja e ngushtë me Crystal System si dhe sigurimin e punësimit për rreth 50% të studentëve e mbështet këtë proces. Gjithashtu institucioni vë në dispozicion (<i>Dosja e Programit të Studimit dhe të Kërkimi i Tregut për Sistemet ERP</i>) mundësitë e punësimit të studentëve. Si u përmend më sipër GVJ sugjeron për të ardhmen një fushatë më intensive në informimin e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë për këtë program studimi duke pasur parasysh perspektivën e zhvillimit të tij dhe kërkesat e vazhdueshme që do të ketë

	tregu për specialistë që diplomohen në këtë program studimi.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konfirmon se studentëve u vihet në dispozicion infrastruktura e nevojshme për arritjen e objektivave për lëndë specifike. Në funksion të këtij programi ka një laborator të dedikuar dhe kjo ndikon në familiarizimin e studentëve me logjistikën dhe infrastrukturën në funksion të këtij programi që në javët e para të mësimit. Studentët e këtij programi studimi mund të zhvillojnë praktikën dhe të konsolidojnë njohuritë e marra edhe në ambientet e biznesit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UAMD-së. Megjithatë në RVB dhe dokumenta të tjerë të paraqitur nga institucioni nuk paraqiten evidence për sistem të brendshëm menaxhimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e FTI-së e cila i percjell ato te koordinatori i MP në Sistemet ERP dhe në zyrën e ALUMNI.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Duke konsideruar se MP në Sistemet ERP ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2018-2019, nuk është e mundur që të ndërtohen raporte krahasuese mbi cilësinë e studentëve. Referuar dokumentit (<i>Aneks 19. Të dhëna për studentët</i>), viti akademik 2018-2019 rezultonin te regjistruar 20 studentë . Në këta studentë të regjistruar, mesatarja në hyrje është 5,85

<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>dhe mesatarja në dalje është 6,76.</p> <p>Për cdo student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat që nga rregjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim/diplomim të tyre.</p> <p>GVJ gjykon që mesatarja për këtë program studimi është e ulët prandaj sugjerohet që të bëhen më shumë përpjekje në reklamimin e masterit edhe më gjerë se UAMD për të rritur shanset e tërheqjes së studentëve me mesatare më të lartë.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore menaxhohen kryesisht nga:sekretaria mësimore e FTI, koordinatori i MP në Sistemet ERP, dhe zyra e ALUMNI.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të UAMD-së sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik.</p> <p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - -Senatin Akademik të UAMD;

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - -komisionet zgjedhore në nivel institucional; - -njësie kryesore; - -komisione të përhershme si NJBSC; - -Këshillin e Etikës etj; 			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni e ka parashikuar në rregulloren e FTI ngarkesën e lejuar për të gjitha programet e studimit dhe programin MP në Sistemet e ERP respekton të njëjtën rregullore.</p> <p>Ngarkesa është në përputhje me aktet nënligjore (jo më tepër se 25 orë në javë) dhe parashikon 15 orë mësimore në javë në auditor. Njohja e krediteve nga studime të mëparshme zhvillohet nga komisioni i transferimeve i cili përcakton përputhshmërinë e tyre me lëndët e ofruara në MP në Sistemet ERP.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>MP në Sistemet ERP ka vetëm një vit që është aktiv, prandaj është herët për të gjykuar për përfshirjen e studentëve në rishikim/përmirësim të programit të studimit. Megjithatë nga takimi në institucion, stafi përgjegjës për këtë program studimi, shprehet se opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e orareve, shpërndarjes së provimeve.</p> <p>GVJ gjykon që duke qenë se është një program i ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me biznesin dhe nevojat specifike për kompetenca të caktuara janë reflektuar, kriteri përmbushet.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>FTI ka parashikuar në rregulloren e tij procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Këto rregullore janë aplikuar edhe në programin MP në Sisteme ERP.</p> <p><i>Aneks 4. Rregullore FTI.pdf, neni 53,54,56</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p> <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e</p>	<p>Institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në UAMD është Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p><i>Ky sektor është përgjegjes për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ procesin e këshillimit të karrierës; ○ ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; ○ mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni; ○ krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për zhvillimin e praktikës së studentëve; ○ krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi punësimi për studentët; ○ organizon aktivitete për studentët; ○ organizon trajnime, seminare, Workshop-e, harton etj; <p>Për programin e studimit MP në Sistemet ERP informimi i studentëve për mundësitë e punësimit, trajnimet dhe kontaktet me studentët e diplomuar, një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë me biznesin. Punësimi i një pjesë të konsiderueshme të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi është një tregues suksesi për programin.</p>

punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe programin MP në Sistemet ERP. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Funkcioni i kësaj zyre është në përputhje të plotë të misionit të institucionit. SBC si strukturë, është e paraparë në Statutin e UAMD me detyrime të qarta dhe të plotareferuar (<i>Aneks 1. Statuti UAMD neni 77</i>). Ky komision ka për detyrë garantimin e cilësisë së brendshme të UAMD dhe të programeve që ofrohen prej tij, në përputhje me standartet kombëtare. NJBSC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FTI. <i>Aneks 1. Statuti UAMD</i> <i>Aneks 6. Rregullore NJBSC</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen

<p>zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Monnitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti, kur kjo kërkohet nga dekani ose rregulloret institucionale. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>(Aneks 6. Rregullore NJBSC.)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në dokumentin strategjik <i>(Aneks 6. Rregullore NJBSC)</i>.</p> <p><i>Megjithatë GVJ sugjeron që ky dokument duhet të shoqërohet edhe me një plan kalendarik në të cilin të parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</i></p> <p>Në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e njëjësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UAMD rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe Departamenti si njësi përgjegjëse për programin e studimit. Në programin e studimit MP në Sistemet ERP një kontribut të rëndësishëm në monitorimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit ka dhe lidhja me biznesin.</p> <p>Referuar RVB UAMD përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese. Monitorimi i realizimit të programit realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve</p> <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>NJSBC përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike (<i>Neni 12 aneks 6 Rregullore NJBSC</i>).</p> <p>Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC.</p> <p>NJBSC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NJBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve.</p> <p><i>Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit; - mundësitë e punësimit të të diplomuarve; - profilin e popullatës studentore; - raportin pedagog/studentë; - plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre; - efektivitetin e pedagogëve; - koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre;

	<ul style="list-style-type: none"> - monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve; - nivelin e largimit/transferimit të studentëve; - numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen; - treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm. 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Nuk përmbushet</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të programit MP në Sistemet ERP, strukturat përgjegjëse përdorin instrumenta të përdorur në programe të tjerë studimi në UAMD.</p> <p>Të dhënat ofrohen nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinioni i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p>	<p>Vlerësimet e bazuara në monitorimin e aktivitetit mësimor të masterit realizohet si nga NJBSC e UAMD ashtu edhe nga ajo e FTI, ndërkohë që anketimi i studentëve dhe personeli akademik realizohet në nivel institucioni, njësie kryesore</p>

<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>dhe në rastin e këtij program studimi edhe nga biznesi.</p> <p>MP në sistemet ERP ka diplomuar brezin e parë të studentëve dhe anketimi i studentëve të diplomuar do të zhvillohet në vitet akademike që vijojnë. Megjithatë ndërtimi i programit të studimit në bashkëpunim me biznesin përbën një pikë të fortë për këtë program studimi.</p> <p>Nga takimet midis GVJ-së stafit të angazhuar në këtë program studimi dhe biznesin u konstatua që lidhja midis tyre do të jetë në vazhdimësi për të reflektuar nevojat e biznesit. <i>Megjithatë këshillohet lidhja dhe me biznese të tjera për të rritur qëndrueshmërinë në kohë të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e</p>	<p>Programi monitorohet dhe përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme nga bashkëpunimi që është vendosur me</p>

<p>brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>biznesin.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në institucion janë të përcaktuar qartë njësitë që janë përgjegjëse për programin e studimit MP në sisteme ERP. Koordinator i programit shërben si një urë lidhëse midis biznesit dhe njësisë që strehon këtë program studimi. Po kështu kontaktet e vazhdueshme me studentët bëjnë që të gjitha palët të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjes së tij me nevojat më të fundit të tregut.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Kriteri plotësohet, institucioni përfshin si aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit ashtu edhe stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Nga takimi i GVJ me biznesin, rezulton që ky i fundit ofron ekspertizë të vazhdueshme për përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu prania e lektorëve të huaj dhe trajnimi i lektorëve shqiptarë njëkohësisht është një tjetër vlerë e shtuar në kuadër të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Institucioni është i pajisur me strukturat përgjegjëse që sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të cilësië, megjithatë GVJ gjykon që krahas rregullore së NJSBC-së, institucioni duhet të hartojë edhe një plan pune sipas një plani kalendarik (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni publikon rezultatet si është parashikuar në rregullore. Kështu sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët, rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësave të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat.</p> <p>Brenda muajit Shtator, fakultetet sipas rregullore së dërgojnë rezultatet e vlerësimit të stafit akademik për të dy semestrat, sipas departamenteve.</p> <p>Në rregulloren e FTI paraqiten edhe detyrimet që duhet të plotësojnë pedagogët me vlerësim jo të mirë, sipas shkallës së përcaktuar në Aneksin IV.</p> <p><i>Aneks 6. Rregullore NJBSC</i> <i>Aneks 4. Rregullore FTI.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Koordinatori i MP në Sistemet ERP organizon takime periodike me studentët. Në këto takime studentët informohen me çdo aktivitet që lidhet me MP në Sistemet ERP si dhe me SBC. Këto takime shërbejnë edhe që studentët të japin feedback-un e tyre për problemet e ndryshme që mund të kenë.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “ Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi Master Profesional në ERP është risi në ofertën akademike në vend, dhe i përgjigjet nevojave të biznesit, për personel të trajnuar dhe kualifikuar specifikisht në këtë fushë;
2. Bashkëpunimi i ngushtë me aktorët e tregut të punës me ekspertizë specifike profesionale, dhe përfshirja e tyre në procesin e rishikimit të programit të studimit, sjell një harmonizim të mirë të njohurive teorike me ato praktike. Njëkohësisht ky bashkëpunim lehtëson punësimin e studentëve pas diplomimit;
3. Mësimdhënia e mbështetur në metoda bashkëkohore dhe e orientuar nga kompetencat e nevojitura nga tregu;
4. Ofrimi i një pjesë të mirë të kurseve profesionale nga lektorë të huaj rrit cilësinë e programit të studimit, por është edhe një praktikë e mirë në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave me lektorët shqiptarë;
5. Shfrytëzimi i ambienteve të biznesit për qëllime të programit të studimit influencon gjithashtu në cilësinë e tij;
6. Përvoja e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ku shumica janë të punësuar, lehtëson mësimdhënien interaktive dhe mundëson shkëmbimin e eksperiencave praktike;

b. Pika të dobta:

1. Niveli i ulët i njohurive të gjuhës së huaj (kryesisht angleze) të studentëve, të cilët e kufizojnë mundësinë e tyre për të ndjekur lektorin në gjuhë të huaj, por edhe për të konsultuar materiale në gjuhë të huaj;
2. Mungesa e dokumentimit të vazhdueshëm nga ana e zyrës së NJSBC-së, si dhe një plan kalendarik për aktivitetet monitoruese për program studimi;
3. Varësia nga lektorët e huaj dhe nevoja për trajnime të vazhdueshme, për të siguruar cilësi të qëndrueshme;
4. Marketimi i dobët i programit të studimit te një audiencë më e gjerë studentësh dhe profesionistësh;
5. Mungesa e literaturës në shqip për një pjesë të moduleve të këtij programi studimi;

Handwritten initials and a signature in blue ink.

6. Mungesa e një sistemi informacioni të integruar;

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që të intensifikohen bashkëpunimet edhe me operatorë të tjerë të biznesit për të kuptuar jo vetëm nevojat aktuale por dhe ato të ardhshme në lidhje me kompetencat që nevojiten nga tregu;
2. GVJ rekomandon që zyra e Alumnit dhe Komunikimit të bëjë më shumë përpjekje për të komunikuar programin te studentë të punësuar, sepse krijimi i klasave mikse me studentë që vijnë nga niveli bachelor dhe studentë të punësuar rrit interaktivitetin dhe përmirëson cilësinë e programit të studimit në tërësi;
3. GVJ rekomandon pajisjen me textbooks në shqip për studentët e këtij programi studimi dhe zbatimin e një plani të detajuar të përvitshëm, me propozim nga njësia bazë, për shtimin e fondit të bibliotekës dhe për pasurimin cilësor të saj më literaturë bashkekohore si dhe:
 - a) përditësimin me titujt e botimeve të fundit, shtimin e numrit të kopjeve në bibliotekë si dhe të ketë një organizim më efektiv si dhe hapësira më komode;
 - b) krijimin e kushteve për akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Questia, Social Science Library, Elsevier;
4. GVJ rekomandon që institucioni në kuadër të NJSBC, të hartojë në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet si më poshtë:
 - a) Identifikimin i praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to;
 - b) Hartimi i një plani kalendarik në të cilin të parashikohet plani i veprimit, ku programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse;
 - c) mekanizmat për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë;
 - d) përfshirjen në pyetësorët e studentëve, të pyetjeve specifike rreth kompetencave të fituara nga studentët për të siguruar informacion rreth realizimit të objektivave;
5. GVJ rekomandon implementimin e një sistemi informacioni të integruar për manaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, për procedurat e konkurrimit, seleksionimit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj;
6. GVJ rekomandon gjithashtu implementimin e një sistemi të integruar të manaxhimit të informacionit, i cili garanton monitorim dhe siguron raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese, titullarët apo ekspertët e jashtëm;

Evaluation Process of the study program “Professional Master in: “Enterprise Resource Planning Systems”

a. Strengths and affirmations:

1. The ERP Professional Master's Program is a novelty in the Albanian academic offer and responds to the business needs for more qualified work force in Enterprise Resource Planning systems;

2. Close cooperation with specific professional expertise from the labor market, and their direct involvement in the study program review process, results in a good harmonization of theoretical and practical knowledge. In the same vein, this collaboration facilitates the employment of the prospect students after graduation;
3. Contemporary teaching methods skills and competences oriented;
4. The lecturing of some of the courses from foreign professors improves the quality of the study program and it represent a good practice in terms of exchanging experiences with Albanian lecturers;
5. The use of business premises for specific professional courses of this study program enhances the quality of the acquired skills and competences from the students of this study program;
6. The experience and the diversity of the students enrolled in this study program, facilitates the interactive teaching and enables the exchange of practical experiences;

b. Weaknesses:

1. Low level of foreign language knowledge (mainly English) of students, which limits their ability to follow a lecturer in a foreign language but also to consult materials in a foreign language;
2. Lack of documentation of the quality assurance office activities, lack of an activity plan of this office concerning the monitoring activities for each study program;
3. Dependence on foreign lecturers for this study program and the need for continuous training to ensure consistent quality;
4. Poor communication of the study program to a wider audience of students and professional;
5. Lack of literature in Albanian language for some modules of this study program;
6. Lack of an integrated information system;

Recomandations:

1. Improvement of the cooperation with the business actors to better realise the actual and future needs and competences required by job market;
2. Alumni and communication office should increase their marketing efforts among the already employed students. We consider that the creation of mix classes from students coming from the bachelor level and those who are already employed students, increases the interaction and improves the quality of the whole study program;
3. The HEI should enrich the number of textbooks in Albanian language and the Department should prepare an annual activity plan in order to enrich the library in order to Increase and update the library entries on the basic and additional literature for each module, as well as increase of the reviews in hard copy, or by subscription on online or digital libraries;
4. The quality assurance unit should prepare an activity plan for its activities as following
 - a) Identification of best practices and problems, and ways to address them;
 - b) Draft an annual activity plan where are specified the activities, the monitoring, and evaluation to be performed and foresee the respective findings;
 - c) Instruments for quality assurance and continuous improvement of the procedures realised in order to assure the quality;

- d) Include in the students survey specific questions on acquired competences, on how to gather the information or if they have achieved their objectives;
5. Implementation of an integrated information system for the management of multi annual information on academic and non-academic staff the procedures of application selection recruitment, and the annual improvements;
6. Implementation of an integrated information system on information management assuring monitoring and individual reporting and real time information for the HEI authorities, or external experts;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD. Elena KOKTHI

PhD. Jonida TETA

